



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosove, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Rregulloren nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionit të Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

**K O N K U R S**

për plotësimin e vendit të lirë të punës

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	<b>Këshilltar – punëtor social</b>
Numri i referencës:	5/2018
Grada/Koeficienti:	Niveli Profesional – G4/14.84
Mbikëqyrësi:	Drejtori i departamentit për parandalimin e torturës
Kohëzgjatja e emërimit:	Pa afat, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1(një) vjeçare.
Vendi:	Prishtinë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:**

1. Si pjesë e grupit shumë-disiplinor, viziton rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, me ç’rast harton raportin, i cili përmban fakte të konstatuara dhe rekomandime, të cilin ia përcjell drejtorit të departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme rreth masave që duhet marrë me qëllim të mënjanimin të veprimeve të paligjshme dhe të rivendosjes së të drejtave të personave të privuar nga liria;
2. Si pjesë e grupit shumë-disiplinor, viziton të paraburgosurit dhe korrespondon me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruar, me ç’rast harton raporte me rekomandime specifike të cilat ia përcjell drejtorit të departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme;
3. Përkujdeset dhe realizon qasjen në informatat për gjendjen e personave të privuar nga liria, përfshirë: trajtimin psikosocial individual për dënimet e gjata, të huajve, personave që nuk shikojnë apo dëgjojnë, dosjet psikosociale dhe plotësimi i tyre, edukimin, aktivitetet ditore, arsimin e detyrueshëm, zhvillimin e punëve artizanale, baza materiale edukative-sportive, ambientet e edukimit, biblioteka, intervalet e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta, mbajtja e lidhjes me familjen, dhënia e literaturës në përdorim dhe çështje tjera, për të cilat bën rekomandime përkatëse, të cilat ia përcjell drejtorit të departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme;
4. Jep sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, lidhur me: ambientet e takimit me familjaret, takimet e veçanta, takimet speciale, kushtet e tyre, mbikëqyrja, telefonatat dhe intervalet e tyre, pranimi dhe nisja e korrespondencës private dhe çështje tjera, të cilat ia përcjell drejtorit të departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme;
5. Kryen vizita monitoruese, si pjesë e grupit shumë-disiplinor, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria dhe bën mbledhjen e informacionit mbi trajtimin e personave të privuar nga liria lidhur me: kushtet e qelive, izolimin, ajrimit, ushqimit, komunikimi me botën e jashtme, praktika e masës disiplinore, opinionin i mjekut, garantimi i të drejtës për apelim, llojet e masave, kohëzgjatja e periudhës, motivet e veçimit;
6. Bën rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria lidhur me: procedurat e administrimit të sendeve të ndaluara, shoqërimi nga policia, kamerat e sigurisë, raportet e shërbimit, masa disiplinore ndaj policeve, llojet e trajnimeve, dhe të tjera çështje të parashikuara me Planin e inspektimit dhe Formularin e Monitorimit, të cilat ia përcjell drejtorit të departamentit për shqyrtim dhe veprim të mëtejme;

7. Udhëheq grupet punuese në çështjet profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë, ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda IAP, si dhe ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda departamentit për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre;
8. Merr pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca, në suaza të trajtimit të çështjeve nga fushëveprimtaria e departamentit;
9. Merr pjesë në përgatitjen e Planit Vjetor të punës së MKPT, përpilon raporte të rregullta pune në baza mujore, tremujore dhe vjetore, dhe sipas kërkesave të menaxhmentit, bën analiza të veçanta nga fusha e përgjegjësive të departamentit;
10. Kryen edhe detyra të tjera, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat me arsye mund të kërkohen kohë pas kohe.

#### **Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:**

- Diplomë universitare në shkencë sociale;
- Së paku 2 (dy) vjet përvojë pune profesionale;
- Njohje të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe, ndërsa preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar;
- Trajnime përkatëse në fushën e të Drejtave të Njeriut;
- Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale, jo më i vjetër se 6 muaj.

---

#### **Procedura e konkurimit**

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org).

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën [zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org](mailto:zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org), si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për veprë penale.

#### **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 27 prill 2018, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.